



Nr.____Prot. Tiranë më, 18.10. 2021

Nr.____Prot. Tiranë më, 18.10. 2021

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
DHE
BASHKISË TIRANË
PËR
PROMOVIMIN E PJESËTARËVE TË DIASPORËS DHE
BASHKËRENDIMIN PËR ÇËSHITJE TË LIDHURA ME
DIASPORËN



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) dhe Bashkia e Tiranës (BT) (në vijim referuar individualisht si "Palë" dhe sëbashku "Palët") në vlerësim të qëllimeve të përbashkëta për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, në nxitjen e promovimit e të rinjve shqiptarë në diasporë, në fushën e artit, kulturës, sportit si dhe përfaqësuesve nga diaspora në fushën e ekonomisë dhe inovacionit, si dhe konsultimin e ndërsjelltë për çështje që lidhen me diasporën;

Në zbatim të Ligjit Nr.16/2018 "Për Diasporën", Ligjit nr.115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Duke njohur rëndësinë e angazhimit dhe përfshirjes së pjesëtarëve të diasporës në zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit;

Me synimin e përbashkët për të bashkëpunuar dhe koordinuar aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e statusit të diasporës shqiptare;

Duke shprehur vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje;

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është krijimi i marrëdhënies së bashkëpunimit, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Bashkisë Tiranë, me qëllim nxitjen e organizimeve, aktiviteteve të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me diasporën shqiptare; promovimin e pjesëtarëve të diasporës në fushën e artit, kulturës, sportit, nxitjes së inovacionit e më gjerë, si dhe në nxitjen vijimësisë së konsultimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor dhe Agjencisë për çështje të lidhura me diasporën.
2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 2

Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok, në përputhje me procedurat e zbatueshme dhe vendimet e organeve kompetente si dhe do t'u përgjigjen kërkesave për bashkëpunim, në përputhje me modalitetet e rakorduara për t'u ndjekur reciprokisht sipas kësaj marrëveshjeje dhe akteve të tjera të dakortësuara sipas rregullave ndërmjet palëve.
2. Palët, në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, gjatë bashkëpunimit të tyre sipas kësaj marrëveshjeje dhe në varësi të burimeve në dispozicion, do të zhvillojnë konsultime për të gjitha çështjet me interes të përbashkët. Për këtë qëllim, Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur ligjor për këto konsultime kurdo që të jetë e nevojshme me synim implementimin me sukses të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje.
3. Palët bien dakord për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe realizimin e interesave të përbashkëta, në lidhje me promovimin e pjesëtarëve të diasporës shqiptare në fushën e artit, kulturës, sportit dhe me gjere.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, gjatë kohëzgjatjes së bashkëpunimit të tyre në varësi të disponueshmërisë së burimeve, bien dakord të përkrahin, nxisin dhe zhvillojnë aktivitete të përbashkëta për promovimin e pjesëtarëve të diasporës në fushën e artit, kulturës, sportit e më gjerë, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, të trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.
2. Palët angazhohen në ngritjen e Këshillit Rinor në Diasporë. Anëtarët e tij do të jenë pjesëtarë të diasporës me histori suksesi në fushën e artit, kulturës, sportit të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në promovimin dhe zhvillimin e qytetit. Procedurat dhe rregullat mbi të cilat do të krijohet Këshilli, do të bazohen mbi legjislacionin e zbatueshëm dhe në një rregullore të posaçme të miratuar nga palët.
3. Palët angazhohen në hartimin e nismave dhe projekteve të përbashkëta për realizimin me sukses të qëllimit të kësaj marrëveshjeje;
4. Palët angazhohen të zhvillojnë aktivitete mbi bazën e programeve vjetore të miratuara nga palët.
5. Palët bashkëpunojnë në krijimin e programit për të mbajtur kontakte të rregullta dhe për të zhvilluar një bashkëpunim praktik në çështjet që kanë të bëjnë me promovimin e pjesëtarëve të diasporës.



Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët do të marrin masat dhe veprimet e duhura ligjore për të siguruar bashkëpunimin dhe ndërlidhjen efektive ndërmjet tyre, përsa i takon bashkëpunimit në fushën e diasporës.
2. Agjencia Kombetare e Diasporës dhe Bashkia Tiranë do të konsultohen rregullisht në respektim të legjislacionit të zbatueshëm për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Marrëveshje shtesë

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Bashkia Tiranë në kuadër të kësaj marrëveshjeje për arritjen e qëllimit të kësaj marrëveshjeje dhe realizimin e nismave të përbashkëta do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme sipas rregullave për lidhjen e marrëveshjeve ose kontratave të veçanta shtesë,

Palët mund të bien dakord për marrëveshje shtesë në rast se mund ta gjykojnë të përshtatshme nga pikëpamja e eksperiencës, për të përmirësuar ose zhvilluar një aspekt të caktuar të bashkëpunimit të tyre.

Neni 6

Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përpunohet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do të komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Secila Palë, nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe/ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe/ose Donatorin përkatës.
4. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 7

Zgjidhja e konflikteve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë Gjykatës kompetente.

Neni 8

Hyrja në fuqi, amendimet dhe kohëzgjatja

1. Nënshkruar më 18 Tetor 2021 në Tiranë, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe,. Secila nga palët në këtë marrëveshje merr një kopje në gjuhën shqipe.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të bëhet vetëm me shkrim nga njëra Palë dhe do të hyjë në fuqi pas pranimi të saj me shkrim nga Pala tjetër.
3. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër.
4. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy Palëve.

BASHKIA TIRANË

**KRYETAR
ERION VELIAJ**

**AGJENCIA
KOMBËTARE E DIASPORËS
DREJTOR EKZEKUTIV
SONILA HYSI**